



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe
Financat

Tiranë, më 16.7.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9975,
DATË 28.7.2008 “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

- ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 18 qershor dhe 16 korrik 2019, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.

Projektligji është propozuar nga deputeti Ilir Beqja. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Mbështetur në nenin 36 të Rregullores së Kuvendit, në datën 18 qershor 2019 Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e grupeve të interesit: Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë dhe Dhomen Amerikane të Tregtisë, të cilët paraqitën mendimet dhe vërejtjet e tyre për projektligjin. Këto mendime e vërejtje trajtohen më poshtë.

Komisioni caktoi relatore për këtë projektligj znj. Antoneta Dhima. Deputeti Ilir Beqja, nismëtar i projektligjit, paraqiti projektligjin dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit.***

Projektligji mbështetet në nenet 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës. Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 të Rregullores së

Kuvendit.

- ***Historik mbi taksën e ambalazheve plastike.***

Taksa mbi ambalazhet plastike është vendosur për shkak të ndotjes që sjellin këto produkte në mjedis dhe politikave për reduktimin e saj. Deri në fund të vitit 2018, taksa për ambalazhet plastike ishte 100 lekë/kg dhe zbatohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas. Taksa për ambalazhet plastike të prodhuara nga industria vendase e riciklimit të mbetjeve plastike ishte 1 lekë/kg.

Gjatë zbatimit në praktikë të këtij ligji u evidentuan disa problematika, si:

- Diskriminimi i biznesit që importonte ambalazhe plastike, për shkak të diferencës së madhe në nivelin e taksës me ambalazhet plastike të prodhuara në vend;
- Evazioni fiskal në mbledhjen e taksës së ambalazheve plastike të prodhuara në vend. Kjo ndodhi për arsye se prodhuesit vendas deklarorin sasi minimale të prodhimit të ambalazhit plastik, që kishte taksë 100 lekë/kg dhe rrisnin deklarimin për lëndët e para plastike “jo ambalazh”, të cilat nuk ngarkoheshin me këtë taksë. Kjo solli reduktimin e të ardhurave të mbledhura nga kjo taksë.

Paketa fiskale, e miratuar në fund të vitit 2018, e cila hyri në fuqi më 1 janar 2019, synoi të zgjidhte problematikat e mësipërme, ndaj solli ndryshimet si më poshtë:

- U vendos taksë jo vetëm mbi ambalazhet plastike, por edhe mbi materialet plastike të importit, si dhe lëndët e para për prodhimin e ambalazhit plastik në vend, në formën e granulit. Ky ndryshim lidhet me faktin që si ambalazhet plastike, ashtu edhe materialet plastike, ndikojnë njëllë në ndotjen e mjedisit.
- U ndryshua niveli i taksës, si më poshtë:
 - Taksa për materialet plastike dhe ambalazhet plastike të importuara u reduktua nga 100 lekë/kg, në 35 lekë/kg;
 - Taksa për lëndën e parë të importuar për prodhimin brenda vendit të produkteve të plastikës u caktua 25 lekë/kg. Kjo taksë u vendos mbi lëndën e parë dhe jo mbi produktin e gatshëm, për arsye të lehtësisë së mbledhjes së saj në çastin e importit, krahasuar me çastin e shitjes së produktit të gatshëm të prodhuar në vend.
 - Taksa e ambalazheve të qelqit, si të importit, ashtu edhe të vendit, u caktua 5 lekë/kg.

Ndryshimi i nivelit të taksës midis materialeve plastike të importit dhe atyre të prodhuara në vend

u argumentua me faktin që lënda e parë pëson firo gjatë procesit teknologjik të shndërrimit në produkt të gatshëm.

Synimet e këtyre ndryshimeve ishin:

- Reduktimi i nivelit të taksës për produktet e plastikës;
- Heqja e diferencimit në nivelin e taksës për ambalazhet plastike të importit, krahasuar me ato të prodhuara në vend dhe vendosja e një konkurrence të drejtë në treg;
- Zgjerimi i bazës së taksueshme në industrisë vendase të plastikës, nëpërmjet politikave për eliminimin e shmangjeve nga pagimi i saj.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.***

Projektligji synon të vijojë e thellojë më tej masat lehtësuese fiskale, të miratuara në paketën fiskale të vitit 2019 në fushën e materialeve dhe ambalazheve plastike. Konkretisht, shtesat dhe ndryshimet e propozuara në ligjin ekzistues synojnë:

- Lehtësimin e barrës së taksave të lëndëve të para për prodhimin e artikujve të plastikës, të prodhuar në vend. Taksa mbi lëndët e para primare, të cilat importohen për prodhimin e artikujve të plastikës në vend parashikohet të reduktohet nga 25 lekë/kg, në 10 lekë/kg.
- Rimbursimin e taksës jo vetëm për ambalazhet që eksportohen, por edhe për çdo artikull tjetër plastik që eksportohet, si lëndë të para, si dhe materiale e artikuj prej plastike.
- Përfshirjen nga pagimi i taksës të një sërë lëndësh të para dhe artikujsh plastikë, të cilat përdoren në procese teknologjike për prodhimin e mallrave joplastikë, si dhe i lëndëve të para që përdoren në industrinë e ndërtimit, në funksion të efikasitetit të energjisë, industrinë e prodhimit të mobiljeve dhe sallameve.

- ***Efektet financiare të projektligjit.***

Sipas relacionit të projektligjit, ulja e nivelit të taksës për lëndët e para primare shoqërohet me një efekt prej 200-225 milionë lekë/vit. Duke qenë se ky ligj parashikohet të hyjë në fuqi gjatë gjysmës së dytë të vitit, ky efekt përgjysmohet.

- ***Propozimet e grupeve të interesit.***

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë paraqiti disa propozime rreth projektligjit, si më poshtë:

- Përfshirja, nga pagimi i taksës së ambalazheve plastike, i lëndëve të para plastike që përdoren për prodhimin e produkteve joplastike, si dhe lëndëve të para primare në

industrinë e ndërtimit, prodhimit të mobiljeve dhe të sallameve.

- Reduktimi nga 10 lekë/kg, në 5 lekë/kg i nivelit të taksës për lëndët e para primare për prodhimin në vend të produkteve plastike, sipas referencave përkatëse në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave. Kjo kërkesë synon lehtësimin e mëtejshëm të kësaj takse.
- Rimbursimi, nga administrata doganore, i taksës për ambalazhet plastike apo të qelqit, lëndët e para, si dhe materialet apo artikujt prej plastike, të cilat eksportohen dhe për të cilat taksa është paguar në momentin e importit apo prodhimit të tyre.

Dhoma Amerikane e Tregtisë u shpreh kundër reduktimit nga 25 lekë/kg, në 10 lekë/kg të taksës së lëndës së parë për prodhimin e artikujve të plastikës, të prodhuar në vend, me argumentin që krijohen diferencime të mëdha në nivelin e taksave dhe në çmimin e shitjes midis produkteve të vendit dhe të importit. Kjo diferencë nuk justifikohet as me frot teknologjike që pësojnë lëndët e para gjatë procesit të prodhimit, të cilat janë rreth 8-10 për qind.

• ***Diskutimi në Komision.***

Deputeti Ilir Beqja, nismëtar i projektligjit, informoi Komisionin, në mënyrë të detajuar, për të gjitha ndryshimet dhe shtesat e propozuara në projektligj dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Relatorja paraqiti mendimin e saj për projektligjin, duke vënë theksin në risitë që ai sjell për reduktimin e barrës së taksave për prodhuesit vendas të produkteve plastike, si dhe lehtësimin nga taksat të sektorëve të ndërtimit, prodhimit të mobiljeve, bojërave etj.

Gjatë diskutimit deputetët e mbështetën projektligjin, duke vlerësuar rolin që ai do të luajë në reduktimin e barrës fiskale për prodhuesit vendas të produkteve plastike, si dhe në disa industri të tjera, për të siguruar rritjen e efikasitetit të energjisë, lehtësimin e veprimtarisë së biznesit dhe reduktimin e çmimeve për konsumatorët. Ata vlerësuan faktin që projektligji pasqyron kërkesat dhe propozimet e grupeve të interesit në drejtim të lehtësimit të barrës fiskale. Lidhur me propozimin e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë për reduktimin e mëtejshëm, nga 10 lekë/kg, në 5 lekë/kg të nivelit të taksës për lëndët e para primare për prodhimin në vend të produkteve plastike, nismëtar i projektligjit informoi Komisionin se projektligji ruan një raport të drejtë midis nivelit të taksës për materialet dhe ambalazhet plastike të importuara dhe lëndëve të para për prodhim të produkteve plastike brenda vendit. Produkti i gatshëm ka epërsi, pasi hidhet menjëherë në treg, ndërsa lënda e parë pëson firo gjatë procesit teknologjik të prodhimit dhe ka koston përkatëse të përpunimit.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen, deputetët propozuan një amendament që synon përjashtimin nga taksat të profileve PVC për prodhimin e dyerve dhe dritareve. Ky amendament mbështetet në propozimin e paraqitur nga Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë dhe synon rritjen e efikasitetit të energjisë.

- **Përfundim.**

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje, duke i propozuar seancës plenare një amendament, si më poshtë:

Në nenin 2, shkronja “e” të riformulohet si më poshtë:

“e) lëndët e para në forma primare për prodhimin e polisterolit (EPS expanded polysterene), importimi i paneleve, pllakave të polistirenit (XPS extruder polystyrene), **si dhe profileve PVC për prodhimin e dyerve dhe dritareve**, sipas kapitullit 39 të NKM-së, artikuj të cilët përdoren në industrinë e ndërtimit në funksion të efikasitetit të energjisë.”

RELATORJA

Antoneta DHIMA

ZËVENDËSKRYETARI I KOMISIONIT

Arben ELEZI